


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Dhjetor 2024

**Tiranë, më 17 Janar 2025:** Në Dhjetor 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 26 mld lekë, duke u ulur me -31,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me -14,8 %, në krahasim me Nëntor 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 79 mld lekë, duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 7,9 %, në krahasim me Nëntor 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 53 mld lekë, duke u rritur me 51,1 %, krahasuar me Dhjetor 2023 dhe duke u rritur me 23,8 %, në krahasim me Nëntor 2024.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Gjatë vitit 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 373 mld lekë, duke u ulur me -15,4 %, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 894 mld lekë, duke u rritur me 2,5 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 522 mld lekë, duke u rritur me 20,7 %, krahasuar me vitin 2023.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Dhjetor 2024, në uljen e eksporteve prej -31,7 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -18,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,8 pikë përqindje etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me 0,3 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Dhjetor 2024**




Eksportet, gjatë këtij viti janë ulur me -15,4 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,1 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Dhjetor 2024, në rritjen e importeve prej 8,3 %, krahasuar me Dhjetor 2023, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,5 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,4 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,2 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,03 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Dhjetor 2024**



Gjatë vitit 2024, importet janë rritur me 2,5 %, krahasuar me vitin 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,3 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Dhjetor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Dhjetor 2023 janë: Italia (18,0 %), Kosova (15,8 %), Greqia (8,4 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Maqedonia e Veriut (17,3 %), Turqia (60,5 %), Mbretëria e Bashkuar (37,4 %).

Gjatë këtij viti vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (13,9 %), Kosova (9,8 %), Greqia (18,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (3,5 %), etj.

Në muajin Dhjetor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Italia (2,4 %), Kina (33,3 %), Turqia (8,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe në krahasim me Dhjetor 2023 janë: Maqedonia e Veriut (16,4%), Zvicra (15,7 %), Austria (19,1 %), etj.

Gjatë këtij viti, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (4,2 %), Turqia (14,2 %), Greqia (19,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (2,3 %), Maqedonia e Veriut (14,9 %), Zicra (29,8 %), etj.

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Dhjetor 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 55,5 %, të gjithë tregtisë. Në Dhjetor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,5% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (25,1 %), Kina (10,4 %), Turqia (8,2 %), Greqia (7,4 %).

Shkëmbimet tregtare, për vitin 2024, me vendet e BE-së zënë 57,4 % të gjithë tregtisë, Gjatë këtij viti, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,5 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,8 %), Kina (8,5 %), Turqia (8,0 %) dhe Greqia (7,2 %).

Tab.1 Qarkullimi i mallrave, Dhjetor 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	09 - 22	39	52,5	88	67,6	-49	43,8
	10 - 22	38	12,5	83	8,6	-45	45,9
	11 - 22	42	12,9	77	-3,9	-35	54,4
	12 - 22	40	26,1	95	7,7	-54	42,5
	Jan-Dhj 22	487	34,9	950	21,2	-464	51,2
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj 23	440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	26	-31,7	79	8,3	-53	32,6
	Jan-Dhj 24	373	-15,4	894	2,5	-522	41,7

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Dhjetor 2024

	Eksporte				Importe			
	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Jan.- Dhj. 2023	Jan.- Dhj. 2024	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Jan.- Dhj. 2023	Jan.- Dhj. 2024
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>22.403</b>	<b>18.165</b>	<b>316.163</b>	<b>267.158</b>	<b>35.742</b>	<b>39.830</b>	<b>444.412</b>	<b>460.253</b>
Austri	156	81	4.162	2.323	488	395	7.952	7.586
Gjermani	1.691	1.640	23.103	22.024	5.563	5.851	61.605	64.365
Greqi	2.102	1.925	28.658	23.447	4.621	5.809	56.929	68.124
Itali	12.890	10.571	189.000	162.799	15.301	15.664	193.803	189.389
Spanjë	1.886	1.038	18.898	13.001	820	1.343	13.150	13.428
Kroaci	707	265	5.034	3.978	477	322	9.148	4.914
Të tjera të BE-së	2.971	2.645	47.306	39.586	8.473	10.446	101.825	112.445
Mbretëri e Bashkuar	84	116	6.382	1.483	883	916	8.860	9.658
Kinë	1.559	503	10.074	10.430	7.805	10.407	93.750	97.723
Kosovë	3.197	2.693	40.921	36.899	1.200	1.319	11.807	15.766
Maqedonia e Veriut	591	694	15.996	11.828	1.390	1.163	14.172	12.064
Rusi	2	-	10	7	327	225	4.356	3.847
SHBA	5.682	502	9.779	7.054	1.401	2.506	17.300	20.503
Turqi	322	517	5.148	4.847	7.458	8.073	84.598	96.644
Ukrainë	50	106	1.130	3.201	339	259	4.267	3.890
Zvicër	610	90	5.072	2.130	1.132	954	13.922	9.775
Të tjera	3.088	2.284	29.633	27.562	15.075	13.160	175.232	164.257
<b>Gjithsej</b>	<b>37.588</b>	<b>25.669</b>	<b>440.308</b>	<b>372.600</b>	<b>72.752</b>	<b>78.812</b>	<b>872.676</b>	<b>894.381</b>

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Dhjetor 2024

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Jan.- Dhj. 2023	Jan.- Dhj. 2024	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Jan.- Dhj. 2023	Jan.- Dhj. 2024
<b>Gjithsej</b>	<b>37.588</b>	<b>25.669</b>	<b>440.308</b>	<b>372.600</b>	<b>72.752</b>	<b>78.812</b>	<b>872.676</b>	<b>894.381</b>
Ushqime, pije, duhan	4.748	4.843	55.667	53.287	12.424	13.408	145.778	156.127
Minerale, lëndë djegëse, en, el,	7.661	5.188	94.034	70.814	7.901	9.021	101.961	93.157
Produkte kimike dhe plastike	1.548	1.090	16.347	15.257	9.410	10.268	114.053	116.103
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	167	155	2.614	2.030	873	851	13.656	11.555
Prodhime druri dhe letre	794	706	11.179	9.930	2.368	2.788	30.045	29.866
Tekstile dhe këpucë	9.025	7.236	126.308	105.081	7.351	7.194	94.191	86.681
Materiale ndërtimi dhe metale	10.018	2.926	83.243	65.210	10.244	8.811	122.815	120.003
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.724	2.563	39.071	37.581	18.455	22.255	212.947	238.362
Të tjera	904	962	11.845	13.411	3.724	4.214	37.229	42.527

**Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Dhjetor 2024**

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>189.000</b>	<b>162.799</b>	<b>40.921</b>	<b>36.899</b>	<b>28.658</b>	<b>23.447</b>	<b>23.103</b>	<b>22.024</b>
Ushqim, pije duhan	15.260	13.863	6.591	6.456	4.759	4.544	2.029	1.908
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	9.551	13.609	8.169	9.707	8.571	3.001	7.506	5.897
Produkte kimike dhe plastike	6.622	5.528	4.030	3.995	1.051	902	54	79
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.373	1.678	9	6	93	158	22	1
Prodhime druri dhe letre	6.491	5.178	1.206	1.230	1.764	1.586	125	141
Tekstile dhe këpucë	97.654	78.619	207	181	7.016	8.075	9.634	9.158
Materiale ndërtimi dhe metale	24.850	20.850	16.879	12.005	4.287	4.185	1.486	1.025
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	20.802	18.213	2.158	1.998	151	240	1.875	3.359
Të tjera	5.397	5.260	1.671	1.320	966	756	370	457

**Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Dhjetor 2024**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>193.803</b>	<b>189.389</b>	<b>84.598</b>	<b>96.644</b>	<b>93.750</b>	<b>97.723</b>	<b>56.929</b>	<b>68.124</b>
Ushqim, pije duhan	29.099	32.076	5.757	5.429	1.949	1.777	17.269	19.015
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	6.375	4.568	9.460	10.408	41	22	6.284	11.700
Produkte kimike dhe plastike	23.672	23.599	11.854	12.457	8.204	7.740	9.602	11.245
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	10.989	8.897	319	371	878	979	84	142
Prodhime druri dhe letre	6.842	6.149	4.754	4.838	1.946	2.098	3.983	4.016
Tekstile dhe këpucë	42.309	35.770	14.435	12.302	14.179	14.489	5.481	6.293
Materiale ndërtimi dhe metale	24.661	21.818	21.127	28.930	13.397	12.827	8.401	9.004
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	41.198	44.056	12.698	17.701	45.508	49.001	3.982	4.381
Të tjera	8.659	12.456	4.195	4.208	7.647	8.789	1.841	2.328

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri